

Aktivitetet gjate vitit 2015 :

Organizimi i Festivalit Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 10-16 maj 2015

Organizimi i FFKGJ 2015 pati këto synime kryesore :

mbrojtjen, promovimin dhe popullarizimin e vlerave më të mira muzikore, koreografike, etnografike të krijuara prej shekujsh nga populli ynë;

pasqyrimin më të gjerë të të gjitha gjinive të folklorit dhe vlerave të tij si dhe pjesmarrjen e sa më shumë të rinjve në këtë veprimtari kombëtare;

rëndësinë që do t'i kushtohet evidentimit të krijimeve folklorike, me karakter improvizues, lodra me karakter imitativ, pantonimik e humoristik, krijimet që lidhen me festat tradicionale popullore dhe ato me karakter ritual;

si dhe, evidentimin e krijimeve më të lashta duke ruajtur pastërtinë burimore.

të evitohen shfaqjet që denatrojnë folklorin, tendencat dhe elementët e tepruar spektakolarë dhe amatorizmi.

Të dhëna nga organizimi i FFKGJ 2015 :

Në fazën e parë, u bë përzgjedhja e grupeve më të mira, të Qendrave Kulturore pranë Bashkive, Komunave, të grupeve të shoqatave folklorike dhe NGO-ve dhe të individëve të interesuar. **Në këto koncerte të Komunave dhe Bashkive të organizuara në periudhën Janar-Shkurt 2015 morën pjesë rreth 7230 bartës së folklorit, ndër të cilët rreth 1600 fëmijë e të rinj.**

Në fazën e dytë, gjatë muajit Mars, Komisioni Përzgjedhës në bashkëpunim me grupet e punës pranë Qarqeve përzgjedhën numrat më të mira që çdo Qark do të përfaqësohet në FFKGJ 2015. **Në këto koncerte morën pjesë 1756 bartës së folklorit, nga të cilët rreth 350 fëmijë dhe të rinj dhe rreth 400 gra e vajza.**

Në FFKGJ që u zhvillua më 10-16 maj 2015 morrën pjesë rreth 2300 artistë konkurrues si edhe rreth 300 artistë të ftuar.

Në periudhën Janar-Mars është ndjekur realizimi i projektit *“Rigjallërimi i kostumografisë popullore dhe rijetëzimit të artit etnografik”* ku u realizuan 80 kostume popullore përfaqësuese nga 12 qarqet e vendit. Ky projekt përfundoi më datë 25.03.2015. Kostumet ishin element përbërës të FFKGJ 2015. Këto kostume u promovuan në Ceremonitë e hapjes dhe mbylljes së FFKGJ 2015. Mesazhi i rigjallërimit të traditës më të mirë popullore, mishëruar në ngjyra dhe motive, u përcoll nga nxënësit gjirokastritë, të cilët sfiluan rrugëve të Gjirokastrës me kostumet popullore si dhe në skenën e Kalasë.

Në periudhën Mars-Prill me kostumet popullore të realizuara në projektin *“Rigjallërimi i kostumografisë popullore dhe rijetëzimit të artit etnografik”* u realizua botimi i katalogut: *“Kostume tradicionale shqiptare, tradita vazhdon...”* i cili u shpërnda gjatë ditëve të FFKGJ 2015.

Gjatë gjithë këtij viti është ndjekur projekti *“Miq të Monumenteve”* duke angazhuar nxënës të mirëmbajtjes së monumenteve në bashkëpunim me DRKK. Nisma Projekt *“Miku i Monumentit”* është një prej veprimtarive më të rëndësishme që është zyrtarizuar ndërmjet Drejtorive Arsimore në rrethe dhe 6 Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare në Durrës, Shkodër, Vlorë, Berat, Gjirokastrë dhe Korçë. Projekti ka marrë udhë më datë 18 Prill 2014 me një ceremoni të organizuar nga MK, MAS, Bashkia, Prefektura dhe Qarku Durrës. Pas këtij qyteti të gjitha DRKK-të u përfshinë në këtë nismë-projekt dhe aktualisht janë bërë binjakëzime të 166 shkollave me monumentet e kulturës në përgjegjësi administrimi të 6 DRKK-ve. Projekti *“Miq të Monumenteve”* si synim parësor ka angazhimin e nxënësve në mirëmbajtjen e monumenteve.

a. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore, zhvilluar në Lushnjë 23-24 tetor.

b. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë, zhvilluar në Vlorë 21-22 nëntor.

Në këto veprimtari u morr pjesë në Komitetet Organizative të tyre ku u dhanë mendime për mënyrën organizative të këtyre veprimtarive, në takimet e punës me pushtetin vendor në Lushnjë dhe në Vlorë, si dhe u ndoqën aktivitetet.

Në periudhën Janar-Mars, bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike për hartimin e *“Udhëzimit për trashëgiminë kulturore jomateriale”*, e cila ju dërgua institucioneve të vartësisë, të pushtetit vendor dhe qendrave kulturore. U shpërnda gjatë muajit prill në të gjitha institucionet e vartësisë, qendrat kulturore pranë Bashkive, etj. në kuadër të ndihmesës që Ministria e Kulturës jep për të gjithë individëve të interesuar, drejtuesve të kulturës, shoqatave kulturore si dhe institucioneve kulturore të pushtetit vendor në drejtim të ruajtjes, mbrojtjes, menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore jomateriale kombëtare.

Organizimi i veprimtarisë *“Dita Ndërkombëtare e popullit Rom”*, mbi trashëgiminë kulturore Rome, si vlerë e trashëgimisë kulturore Shqiptare. Realizuar më datë 08.04.2015.

Trajnimi mbi Zbatimin e Konventës për Ruajtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Jomateriale 2003. Trajnimi u zhvillua më 14-18 shtator 2015 në ambjentet e Ministrisë së Kulturës.

Në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Jomateriale në Sofie, Bullgari u realizua trajnimi 5 ditor me ekspertë të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Dy ekspertë të UNESCO-s do të lektornë mbi raportin e analizës së nevojave në Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në

Shqipëri si dhe mbi qasjet për zbatimin e Konventës së vitit 2003. Morën pjesë specialistë të Ministrisë së Kulturës, QKVF nga DRKK si dhe nga institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore.

Në bashkëpunim me IAKSA dhe QKVF u realizua Konferenca Post-Festival për FFK të Gjirokastrës. U zhvillua më 29 shtator 2015 në ambjentet e IAKSA.

Në bashkëpunim me IAKSA dhe QKVF u realizua organizimi i Konferencës Post-Festival Folklorik ku u evidentuan risitë, cilësia e paraqitjes së folklorit tonë në skenë si dhe problematikat që nxori në pah organizimi i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2015 si dhe propozime për mënyrat e menaxhimit dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale në të ardhmen.

Përgatitja dhe organizimi i promovimit të FFKGJ 2015 në Panairin Ndërkombëtar “*Ekspo Milano*”, organizuar në qytetin e Milanos, Itali, më 19 tetor 2015.

Për promovimin e FFKGJ 2015 në Panairin Ndërkombëtar “*Ekspo Milano*” organizuar në qytetin e Milanos, më 19 tetor 2015, u realizuan :

a. Prodhimi i një CD audio me numra të zgjedhura nga FFKGJ 2015.

b. Prodhimi i një DVD me dokumentarin kushtuar FFKGJ 2015.

c. Prodhimi i një Albumi me foto nga FFKGJ 2015.

d. U përzgjedh një grup prej 45 artistësh që performuan në Ceremoninë e hapjes në Ditën e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “*Ekspo Milano 2015*”. Ky performim, nga organizatorët e Ekspo Milanos, në mbyllje të Panairit Ndërkombëtar “*Ekspo Milano*”, u rradhit ndër 5 ceremonitë më të mira të organizuara nga të gjitha shtetet pjesmarrëse në këtë Panair.

e. Promovimi i kostumeve popullore shqiptare në këtë Panair, duke veshur 20 të rinj me kostumet popullore të cilët performuan gjatë zhvillimit të ceremonisë.

U ndoq përgatitja dhe nisja e pjesmarrjes së kostumeve popullore të prodhuara nga Ministria e Kulturës për promovimin e tyre në Gjermani.

U përgatit dokumentacioni për ndihmë financiare për edicionin e 21-të të projektit të Festivalit Folklorik “*Oda Dibrane*” si dhe u monitorua ky projekt që u zhvillua në qytetin e Peshkopisë më 29-31 tetor.

Përgatitja dhe organizimi i promovimit të materialeve publicitare të FFKGJ 2015 në Panairin Klik Ekspo Klik, zhvilluar në Tiranë më 21-25 nëntor 2015 në Pallatin e Kongreseve :

Organizimi i veprimtarisë së edicionit të dytë të projektit “*Narracioni i legendave përmes novelave grafike 2*” , zhvilluar në ambjentet e Ministrisë së Kulturës më datë 08.12.2015.

Strategjia “Trego Kulturën Tënde”, e lancuar për herë të parë në vitin 2015, shënoi një hap cilësor në vitin 2015, duke implementuar hartën interaktive të trashëgimisë jomateriale dhe diversitetit kulturor, e cila pasurohet në vijimësi me materialet e ardhura nga bartësit, shoqatat, nxënësit, studentët, aktivistë apo dhe profesionistët e trashëgimisë kulturore jomateriale në gjithë vendin. Kjo hartë u përfunduar zyrtarisht në një ceremoni zyrtare në ambjentet e Ministrisë së Kulturës, aktivitet në të cilin Ministri i Kulturës, znj. Mirela Kumbaro Furxhi u shpërndau medalje mirënjohjeje kontribuesve dhe bashkëpunëtorëve. Në këtë aktivitet iu shpjegua pjesëmarrësve mënyra e funksionimit të faqes dhe hapat e mëtejshëm të funksionimit të saj.

U festua përmes aktiviteteve promovuese dhe sensibilizuese, 8 prilli –Dita Ndërkombëtare e Romëve si dhe u hartua Plani i Veprimit për ruajtjen e identitetit dhe kulturës Rome (pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë për Romët hartuar nga MMSR).

U mundësua pjesëmarrja e grupit “Lunxhëria” në festivalin “Ballkan Trafik” dhe koncerte në Bruksel, në datat 24-26 prill 2015, performanca, të cilat përbëjnë një kontribut më shumë në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë nëpërmjet diplomacisë kulturore dhe njohjes së audiencës me vlerat artistike të trashëgimisë sonë.

Në kuadër bashkëpunimit me Ministrinë e Jashtme për promovimin kulturës shqiptare jashtë vendit, u realizua ekspozimi i kostumeve popullore shqiptare në Essen të Gjermanisë, me rastin e festive të Nëntorit.

Në kuadër të organizimit të përfaqësimit të Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës në Venecia, 2016, u realizuan procedurat e thirrjes për konkurrim dhe përzgjedhjes së subjektit që do të realizojë Pavijonin Shqiptar në këtë Bienale.